



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1463/ 12 prot.

Datë 09/09/2025

V E N D I M
Nr. 1194/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09/09/2025, shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “ED KONSTRUKSION” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-43285-04-02-2025, me objekt: “Shërbim i mirëmbajtjes të sipërfaqeve të gjelbra për QSUNT, për 24 muaj”, me fond limit 35,684,604.80 (tridhjetë e pesë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e katër pikë tetëdhjetë) lekë, pa TVSH ose 359,687.57 (treqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e shtatë pikë pesëdhjetë e shtatë) euro pa tvsh, zhvilluar më datë 05.05.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara Sh.A.

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “ASI INVEST” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “SILVER” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit

- Ankimues:** Operatori ekonomik “*A l b G a r d e n*” SHPK me NIPT: K37513520N dhe me adresë: *Lagja "Skenderbeg", Godinë private I katëshe në superstradën Lezhë - Shkodër, km1, Lezhë.*
- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve të Përqëndruara Sh.A
Adresa: Rruga “Reshit Çollaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë.
- Persona të interesuar:** Operatori ekonomik “*ED KOSNSTRUKSION*” SHPK me NIPT: K61625001 dhe me adresë: *Kryqëzimi i Rrugës "Liman Kaba" me "Prokop Mima", Rezidenca "Olimpik" Shkalla nr. 2, Kati 4, Tiranë.*
- Operatori ekonomik “*ASI INVEST*” SHPK me NIPT: M01927023H dhe me adresë: *Burrel Dibër Burrel, , Rruga “Koke Malci”, nr pasurie 4/49/ND Burrel, Mat.*
- Operatori ekonomik “*SILVER*” SHPK me NIPT: K88010301S dhe me adresë: *Njesia Bashkiake Nr 5, Rruga “Bajram Curri”, Nr.Pasurie 5/247+1N4, Zona Kadastrale 8260, Pallati Palma e Art, Tiranë*
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 03.04.2025 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-43285-04-02-2025, me objekt: “Shërbim i mirëmbajtjes të sipërfaqeve të gjelbra për QSUNT, për 24 muaj”, me fond limit 35,684,604.80 (tridhjetë e pesë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e katër pikë tetëdhjetë) lekë, pa TVSH ose 359,687.57 (treqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e shtatë pikë pesëdhjetë e shtatë) euro pa tvsh, zhvilluar më datë 05.05.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara Sh.A.

II.2. Në datë 05.05.2025 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 22.05.2025 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

1	"ARTEO 2018" SHPK	0 leke	skualifikuar
2	"ED KONSTRUKSION" SHPK	21.741.500 leke	kualifikuar
3	"ASI INVEST" SHPK	24.198.150 leke	kualifikuar
4	"SILVER" SHPK	26.014.985 leke	kualifikuar
5	"AlbGarden" SHPK	26.763.460 leke	kualifikuar
6	"CLEAN FAST" SHPK	27.512.830 leke	kualifikuar
7	"ALKO IMPEX CONSTRUCTION" SHPK	29.122.150 leke	kualifikuar
8	"KORSEL" SHPK	29.912.740 leke	kualifikuar
9	"A.M.E 200" SHPK	30.331.914 leke	kualifikuar
10	"REJ" SHPK	32.074.955 leke	kualifikuar
11	"Pastrime Silvio" SHPK	35.200.945 leke	kualifikuar

II.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronik konstatohet, se në datën 29.05.2025 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit paraprak për procedurën e mësipërme të prokurimit, duke shpallur fitues operatorin ekonomik *"ED KONSTRUKSION"* SHPK.

II.5. Në datën 06.06.2025, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/5392, datë 06.06.2025, dhe me nr. 1463/2025 prot, datë 09.06.2025 e operatorit ekonomik *"AlbGarden"* SHPK, me anë të së cilës kundërshtohet vendimmarrja e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertave së paraqitura nga operatori ekonomik *"ED KONSTRUKSION"* SHPK, operatori ekonomik *"ASI INVEST"* SHPK dhe operatori ekonomik *"SILVER"* SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Në përputhje me nenin 112 "Veprimet paraprake" të Ligjit nr.162/2020 *"Për Prokurimin Publik"*, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 1463/1, datë 09.06.2025 lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues *"AlbGarden"* SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik *"ED KONSTRUKSION"* SHPK, mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik *"ASI INVEST"* SHPK, si dhe mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik *"SILVER"* SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.7. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik *"SILVER"* ShPK ka paraqitur argumenta lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues *"AlbGarden"* ShPK përsa i përket kualifikimit të ofertës së tij sipas parashikimeve të nenit 113 të Ligjit nr.162/2020 *"Për Prokurimin Publik"*, i ndryshuar të cilat janë protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 1463/2 prot., datë 12.06.2025, duke argumentuar si më poshtë vijon:

"... Operatori ekonomik "SILVER" ShPK ka dorëzuar në SPE të gjithë dokumentacionin e kërkuar në KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT. Bashkëlidhur po ju dërgojmë të gjithë dokumentacionin përkatës.

- 1. Faturë tatimore shitje elektronike, nr. XXXX, datë XX/XX/2024, me objekt: "Shërbim gjelbërimi", me vlerë 744.800 leke pa TVSH, lëshuar nga shitësi "SILVER" ShPK për blerësin "XXXX" ShA.*
- 2. Faturë tatimore shitje elektronike, nr XXXX, datë XX/XX/2024, me objekt: "Shërbim pastrim gjelbërimi", me vlerë 327.130 leke pa TVSH, lëshuar nga shitësi "SILVER" ShPK për blerësin autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.*

3. *Faturë tatimore shitje elektronike, nr. XXXX, datë XX/XX/2024, me objekt: “Shërbim pastrim gjelbërimi”, me vlerë 327.130 leke pa TVSH, lëshuar nga shitësi “SILVER” ShPK për blerësin autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.*
4. *Faturë tatimore shitje elektronike, nr. XXXX, datë XX/XX/2024, me objekt: “Shërbim gjelbërimi”, me vlerë 600.000 leke pa TVSH, lëshuar nga shitësi “SILVER” ShPK për blerësin “XXXX” ShA.*
5. *Faturë tatimore shitje elektronike, nr. XXXX, datë XX/XX/2024, me objekt: “Shërbim pastrim gjelbërimi”, me vlerë 327.130 leke pa TVSH, lëshuar nga shitësi “SILVER” ShPK për blerësin autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.*
6. *Faturë tatimore shitje elektronike, nr. XXXX, datë XX/XX/2024, me objekt: “Shërbim gjelbërimi”, me vlerë 483.700 leke pa TVSH, lëshuar nga shitësi “SILVER” ShPK për blerësin “XXXX” ShA.*
7. *Faturë tatimore shitje elektronike, nr. XXXX, datë XX/XX/2024, me objekt: “Shërbim gjelbërimi”, me vlerë 511.000 leke pa TVSH, lëshuar nga shitësi “SILVER” ShPK për blerësin “XXXX” ShA.*
8. *Faturë tatimore shitje elektronike, nr. XXXX, datë XX/XX/2024, me objekt: “Shërbim pastrim gjelbërimi”, me vlerë 327.130 leke pa TVSH, lëshuar nga shitësi “SILVER” ShPK për blerësin autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.*
9. *Faturë tatimore shitje elektronike, nr. XXXX, datë XX/XX/2024, me objekt: “Shërbim pastrim gjelbërimi”, me vlerë 327.130 leke pa TVSH, lëshuar nga shitësi “SILVER” ShPK për blerësin autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.*
10. *Faturë tatimore shitje elektronike, nr. XXXX, datë XX/XX/2024, me objekt: “Shërbim pastrim gjelbërimi”, me vlerë 327.130 leke pa TVSH, lëshuar nga shitësi “SILVER” ShPK për blerësin autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.*
11. *Faturë tatimore shitje elektronike, nr. XXXX, datë XX/XX/2024, me objekt: “Shërbim pastrim gjelbërimi”, me vlerë 327.130 leke pa TVSH, lëshuar nga shitësi “SILVER” ShPK për blerësin autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.*
12. *Faturë tatimore shitje elektronike, nr. XXXX, datë XX/XX/2025, me objekt: “Shërbim pastrim gjelbërimi”, me vlerë 327.130 leke pa TVSH, lëshuar nga shitësi “SILVER” ShPK për blerësin autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.*
13. *Faturë tatimore shitje elektronike, nr. XXXX, datë XX/XX/2025, me objekt: “Shërbim gjelbërimi”, me vlerë 1.954.800 leke pa TVSH, lëshuar nga shitësi “SILVER” ShPK për blerësin “XXXX” ShPK.*

14. Faturë tatimore shitje elektronike, nr. XXXX, datë XX/XX/2025, me objekt: "Shërbim gjelbërimi", me vlerë 600.000 leke pa TVSH, lëshuar nga shitësi "SILVER" ShPK për blerësin "XXXX" ShPK.
15. Faturë tatimore shitje elektronike, nr. XXXX, datë XX/XX/2025, me objekt: "Gjelbërim vilat në Farkë", me vlerë 1.954.800 leke pa TVSH, lëshuar nga shitësi "SILVER" ShPK për blerësin "XXXX" ShPK.
16. Faturë tatimore shitje elektronike, nr. XXXX, datë XX/XX/2025, me objekt: "Shërbim gjelbërimi", me vlerë 880.000 leke pa TVSH, lëshuar nga shitësi "SILVER" ShPK për blerësin "XXXX" ShA.
17. Faturë tatimore shitje elektronike, nr. XXXX, datë XX/XX/2025, me objekt: "Shërbim gjelbërimi; Pastrim territori dhe larje me autobot", me vlerë 1.010.000 leke pa TVSH, lëshuar nga shitësi "SILVER" ShPK për blerësin "XXXX" ShA.
18. Faturë tatimore shitje elektronike, nr. XXXX, datë XX/XX/2025, me objekt: "Shërbim pastrim gjelbërimi", me vlerë 327.130 leke pa TVSH, lëshuar nga shitësi "SILVER" ShPK për blerësin autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.
19. Faturë tatimore shitje elektronike, nr. XXXX, datë XX/XX/2025, me objekt: "Shërbim gjelbërimi", me vlerë 954.500 leke pa TVSH, lëshuar nga shitësi "SILVER" ShPK për blerësin "XXXX" ShA.
20. Faturë tatimore shitje elektronike, nr. XXXX, datë XX/XX/2025, me objekt: "Gjelbërim vilat në Farkë", me vlerë 2.105.400 leke pa TVSH, lëshuar nga shitësi "SILVER" ShPK për blerësin "XXXX" ShPK.
21. Faturë tatimore shitje elektronike, nr. XXXX, datë XX/XX/2025, me objekt: "Shërbim gjelbërimi", me vlerë 998.500 leke pa TVSH, lëshuar nga shitësi "SILVER" ShPK për blerësin "XXXX" ShPK.
22. Faturë tatimore shitje elektronike, nr. XXXX, datë XX/XX/2025, me objekt: "Shërbim pastrim gjelbërimi", me vlerë 327.130 leke pa TVSH, lëshuar nga shitësi "SILVER" ShPK për blerësin autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.
23. Faturë tatimore shitje elektronike, nr. XXXX, datë XX/XX/2025, me objekt: "Shërbim pastrim gjelbërimi", me vlerë 327.130 leke pa TVSH, lëshuar nga shitësi "SILVER" ShPK për blerësin autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.
24. Faturë tatimore shitje elektronike, nr. XXXX, datë XX/XX/2025, me objekt: "Shërbim gjelbërimi", me vlerë 2.570.900 leke pa TVSH, lëshuar nga shitësi "SILVER" ShPK për blerësin "XXXX" ShPK.

25. Faturë tatimore shitje elektronike, nr. XXXX, datë XX/XX/2024, me objekt: “Shërbim pastrim gjelbërimi”, me vlerë 327.130 leke pa TVSH, lëshuar nga shitësi “SILVER” ShPK për blerësin autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

26. Faturë tatimore shitje elektronike, nr. XXXX, datë XX/XX/2024, me objekt: “Shërbim pastrim gjelbërimi”, me vlerë 327.130 leke pa TVSH, lëshuar nga shitësi “SILVER” ShPK për blerësin autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

27. Faturë tatimore shitje elektronike, nr. XXXX, datë XX/XX/2024, me objekt: “Shërbim gjelbërimi”, me vlerë 744.800 leke pa TVSH, lëshuar nga shitësi “SILVER” ShPK për blerësin “XXXX” ShA.”.

II.8. Me shkresën nr. 1088/7 prot, datë 20.06.2025, protokolluar me tonën me nr. 1463/3 prot datë 23.06.2025, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, si dhe vendimarrja për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “AlbGarden” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“...

II.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “AlbGarden” shpk mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “ED KONSTRUKSION” shpk me pretendimin se nuk plotëson kriterin 2.3.1 të dokumenteve të tenderit ku citohet se: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit limit” KSHA vëren se:

Në Dokumentet e Tenderit, Shtojca 9 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.1 e Kapacitetit teknik përcaktohet se: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit

në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pika 4 parashikohet se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.”.

Në nenin 41, pika 3 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre vjetëve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre vjetëve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. ...”.

*Referuar Shtojcës 6 “Formulari i Specifikimeve Teknike” të përcaktuar në Dokumentet e Tenderit përcaktohet: “[...] O.E. është i detyruar të zbatojë me përgjegjshmëri, të gjitha pikat e preventivit sipas planit mujor të punës të miratuar, por edhe të jetë i vëmendshëm në mirëmbajtjen e këtyre sipërfaqeve. **O.E. duhet:***

- Të pastrojë me krehër sipërfaqet e gjelbra, për ta mbajtur të gjelbër dhe të shëndetshëm, këtë sipërfaqe.*
- Të mirëmbajë sipërfaqet e dëmtuara, nga ulja pa kriter e njerëzve dhe nga thatësitë e periudhës së verës.*
- Të ujisë me autobus, sipas sezoneve gjithë sipërfaqen e gjelbërt.*
- Të mos përdorë ujin e pijshëm të QSUT-së, për ujitje.*
- Të ndihmojë profesionalisht për shtimin e sipërfaqeve të gjelbërta dhe ambienteve relaksuese, rreth godinave spitalore.*
- Të jenë bashkëpunues, për çdo të papritur dhe tu përgjigjen kërkesave të Q.S.U.T-së.*
- Të krasit gardhet e gjelbërta dhe drurët në forma bashkëkohore nga specialistë të mirëfilltë.*
- Të vendosen tabela ndërgjegjëse, në vendet e duhura për të ruajtur gjelbërimin.*

[...]

Kontrollet e çdo ditë do të synojnë sa më sipër, por edhe në zërat kryesorë të preventivit:

- Mirëmbajtje lulishtesh me bar natyral.*

- *Mirëmbajtje, ripërtëritje shkurre dekorative.*
- *Pastrim me krëhër i mjedisve të gjelbërta.*
- *Prashitje shkurresh.*
- *Krasitje e gardheve të gjelbra.*
- *Kositje bari me kosë/makinë korrëse dhe largimi i mbeturinave të tyre.*
- *Vaditje sipërfaqe të gjelbërta (bar natyral dhe bar i kultivuar) (përveç ditëve me shi).*
- *Vaditje pemësh, fidanësh.*
- *Të bëhet prashitja e shkurreve/luleve dhe pemëve, sa herë të jetë e nevojshme.*
- *Rikompozimi i sipërfaqeve sipas nevojës dhe kërkesës së AK.*
- *Vendosja e tabelave ndërgjegjëse për mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbërta dhe mbajtjen pastër, të çdo pjese jashtë godinave spitalore.*

Referuar Shtojcës 7 të Dokumentet e Tenderit përcaktohet si më poshtë:

Nr.	Përshkrimi	Njesia	Sasia	Frekuenca per 24 muaj
1	<i>Pastrim me krëhër bari i mjediseve të gjelbërta dhe largimi i tyre</i>	<i>m2</i>	<i>23,855</i>	<i>730</i>
2	<i>Punim me bel, shkriftim plisash, nivelim dhe largim mbeturinash</i>	<i>m2</i>	<i>5,000</i>	<i>24</i>
3	<i>Furnizim dhe mbjellje farë bari (50 g /m2)</i>	<i>m2</i>	<i>5,000</i>	<i>8</i>
4	<i>Prashitje shkurresh dhe druresh+ plehrim kimik drurë (nitrati)</i>	<i>copë</i>	<i>4,650</i>	<i>28</i>
5	<i>Krasitje e gardheve të gjelbra dhe largimi i tyre</i>	<i>ml</i>	<i>1,800</i>	<i>28</i>
6	<i>Pleherim shperndarje me pleh organik</i>	<i>m2</i>	<i>1,000</i>	<i>2</i>
7	<i>Spërkatje me insekticide</i>	<i>copë</i>	<i>300</i>	<i>10</i>
8	<i>Kositje bari me kosë dhe largimi i tyre</i>	<i>m2</i>	<i>23,855</i>	<i>28</i>
9	<i>Vaditje sipërfaqeve të gjelbërta me autobot</i>	<i>m2</i>	<i>23,855</i>	<i>300</i>

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik “ED KONSTRUKSION” shpk, konstaton se ky i fundit, në përmbushje të kriterit të sipërcituar, ka paraqitur Kontratë bazë me nr. 6759/8 prot., datë 18.06.2020, dhe Kontratë shtesë me nr. 37836/4 prot., me objekt: “Rikonceptimi i Kopshtit Zoologjik”, lidhur ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe BOE “G.P.G. Company shpk & “Veko” shpk & “Alba Konstruktion” shpk & “ED Konstruktion” shpk.

Lidhur me këtë kontratë, janë paraqitur:

- Vërtetim realizimi;*

- b. *Situacionet pjesore dhe përmbledhëse;*
- c. *Akt Kolaudimi;*
- d. *Kontratë Bashkimi Përkohshëm i Shoqërive, nr. Rep. 2640; nr. Kol. 810, ku përcaktohet ndarja e punimeve në % për secilin pjesëtar të BOE si dhe ndarja e punimeve sipas Aneksit I bashkëlidhur kësaj kontrate;*

Nga shqyrtimi i Aneksit I bashkëlidhur kontratës së BOE, evidentohet ndarja e zërave të punimeve që merr përsipër të realizojë secila shoqëri, ku konstatohet se në pikën A-5 “Punime H/izolimi dhe tarrace në ambientet e shërbimit”, shoqëria “ED KONSTRUKSION” shpk merr përsipër realizimin e zërave të punimeve 9 dhe 10. Në pikën E-4 “Punime Gjelbërimi”, shoqëria “ED KONSTRUKSION” shpk merr përsipër realizimin e zërave të punimeve 10, 11 dhe 12.

Operatori ekonomik “ED KONSTRUKSION” shpk ka paraqitur Kontrata Shërbimi me objekt: “Shërbimi i Pastrimit në Bashkinë Dimal” lidhur ndërmjet Bashkisë DIMAL dhe BOE “ED KONSTRUKSION” shpk & “Korsel” shpk, përkatësish në datat 20.10.2021, 21.10.2022 dhe 23.10.2023, shoqëruar me vërtetimet e realizimit për secilën kontratë. Gjithashtu, ka paraqitur Akt Marrëveshje (Kontratë Bashkëpunimi) më nr. Rep. 2436 dhe nr. Kol. 952, datë 13.09.2021, ku përcaktohet ndarja e punimeve në % për secilin pjesëtar të BOE si dhe ndaja e punimeve sipas Aneksit I bashkëlidhur kësaj kontrate;

Nga shqyrtimi i Aneksit I bashkëlidhur kontratës së BOE, evidentohet ndarja e zërave të punimeve që merr përsipër të realizojë secila shoqëri, ku konstatohet zëra punimesh për shërbim pastrimi e mirëmbajtje hapësirash publike si fshirje me fshesë dore e rrugeve dhe trotuareve, fshirje me fshesë dore e rrugëve dhe shesheve, grumbullim dhe transportim mbeturina në venddepozitim, fshirje me mjet teknologjik i rrugëve, lagje rruge dhe sheshe me mjet teknologjik, mirëmbajtje venddepozitimit të mbetjeve urbane, larje e dizifektim kontenieresh, larje rruge dhe sheshe me mjet teknologjik, ku qartësisht evidentohet lidhja dhe ngjashmëria me kontratën objekt prokurimi dhe përcaktimet në Shtojcën 6 e Shtojcën 7 të DT.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjykon se krahasueshmëria e kontratave nëse janë të ngjashme i referohet natyrës së kontratave, si dhe zërave konkretë të tyre. Në këtë prizëm elementët konkretë të kontratave të paraqitura në SPE nga operatori ekonomik “ED KONSTRUKSION” shpk, lidhur me Bashkinë Tiranë dhe Bashkinë Dimal, konsiderohen elementë të ngjashëm me objektin e procedurës së prokurimit dhe nuk mund të jenë identikë apo të njëjtë me elementët e përcaktuar në specifikimet teknike të kësaj procedure. Vlen të theksohet fakti se objekti i prokurimit lidhet me punime shërbimi gjelbërimi, që në vetvete referuar edhe Shtojcës 6, nënkupton shërbim pastrimi dhe mirëmbajtje në mënyrë periodike sipas përcaktimeve nga autoriteti kontraktor si pastrim, rehabilitim, prerje-krasitje grumbullim dhe evadim mbetjesh.

KSHA, në gjykimin e saj mbi evidentimin e elementëve të ngjashmëm në kontratat e paraqitura nga shoqëria “ED KONSTRUKSION” shpk, i është referuar pikërisht shërbimit si

proces si dhe mjeteve përkatëse të realizimit, duke shmangur ndonjë funksion specifik pasi, në të kundërt do të gjendej në kushtet e kontratave identike. Në përmbushje të kriterit të përcaktuar në Dokumentet e Tenderit dhe sanskionimit ligjor për eksperiencën e mëparshme ofertuesit duhet të paraqesin kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet dhe jo kontrata identike, pasi për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit por, edhe në përputhje me elementet konkrete të përcaktuar në dokumentet e tenderit dhe specifikimet teknike.

Nga shqyrtimi i zërave dhe elementëve të kontratave të paraqitura nga operatori ekonomik “ED KONSTRUKSION” shpk si kontrata të ngjashme të mëparshme, nga përlllogaritja e zërave të ngjashëm për sa i përket llojit, tipologjisë, emërimit/përshkrimit, me zërat dhe elementët konkretë të kontratës objekt shqyrtimi, rezulton se ky operator ekonomik ka arritur të dëshmojë se ka kryer shërbime të mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit në vlerën e përcaktuar në Dokumentet e Tenderit.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes nuk qëndron.

II.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “AlbGarden” shpk mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “ASI INVEST” shpk me pretendimin se nuk plotëson kriterin 2.3.1 të dokumenteve të tenderit ku citohet se: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit limit” KSHA vëren se:

Në Dokumentet e Tenderit, Shtojca 9 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.1 e Kapacitetit teknik përcaktohet se: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pika 4 parashikohet se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale,

autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.”.

Në nenin 41, pika 3 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre vjetëve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre vjetëve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. ...”.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik “ASI INVEST” shpk, konstaton se ky i fundit, në përmbushje të kriterit të sipërcituar, ka paraqitur fatura tatimore elektronike të shitjes, të realizuar me sektorin privat, për periudhën Prill 2022 — Prill 2024, ku evidentohen datat, shumat dhe bashkëlidhur tyre situacion shërbimi ku evidentohen qartë shërbimet e realizuara. KSHA, pasi verifikoi faturat e paraqitura, konstaton se ato përmbushin kërkesën e përcaktuar në Dokumentet e Tenderit, lidhur me ngjashmërinë me objektin e procedurës së prokurimit, vlerën e përlogaritur si dhe afatin kohor për kryerjen e këtyre shërbimeve gjatë tre viteve të fundit nga publikimi i kontratës objekt prokurimi. Në këtë kontekst, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave e konsideron të përmbushur kriterin e sipërcituar dhe të saktë vlerësimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

II.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “AlbGarden” shpk mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “SILVER” shpk me pretendimin se nuk plotëson kriterin 2.3.1 të dokumenteve të tenderit ku citohet se: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit limit” KSHA vëren se:

Në Dokumentet e Tenderit, Shtojca 9 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.1 e Kapacitetit teknik përcaktohet se: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- c) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të*

kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- d) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pika 4 parashikohet se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.”.

Në nenin 41, pika 3 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre vjetëve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre vjetëve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. ...”.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik “S I L V E R” shpk, konstaton se ky i fundit, në përmbushje të kriterit të sipërcituar, ka paraqitur fatura tatimore elektronike të shitjes, të realizuara me sektorin privat, për periudhën Janar 2024 — Prill 2025, ku evidentohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

KSHA, pasi verifikoi faturat e paraqitura, konstaton se ato përmbushin kërkesën e përcaktuar në Dokumentet e Tenderit, lidhur me ngjashmërinë me objektin e procedurës së prokurimit, vlerën e përllogaritur si dhe afatin kohor për kryerjen e këtyre shërbimeve gjatë tre viteve të fundit nga publikimi i kontratës objekt prokurimi. Nga shqyrtimi i faturave të paraqitura nga operatori ekonomik “S I L V E R” shpk si shërbime të ngjashme të mëparshme, nga përllogaritja e zërave të ngjashëm për sa i përket llojit, tipologjisë, emërimit/përshkrimit, me zërat dhe elementët konkretë të kontratës objekt shqyrtimi, rezulton se ky operator ekonomik ka arritur të dëshmojë se ka kryer shërbime të mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit në vlerën e përcaktuar në Dokumentet e Tenderit.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 114 ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 102 të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës,

VENDOSI

1. Refuzimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “AlbGarden” shpk.
2. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë ankimuesin, brenda ditës së nesërme të punës nga inarrja e këtij vendimi.
3. Personi përgjegjës për prokurimin të njoCojë për vendimin e marrë operatorët ekonomikë të interesuar, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.
4. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.
5. Ky vendim i njoftohet menjëherë Titullarit të Organit Qëndror Blerës.”.

II.9. Në datë 01.07.2025, operatori ekonomik ankimues “AlbGarden” SHPK ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik argumenta shtesë lidhur me shqyrtimin e ankesës së tij nga ana e autoritetit kontraktor, protokolluar me tonën me nr. 1463/4 prot, datë 01.07.2025, duke pretenduar si më poshtë vijon:

“...

7. Bazuar në AK për refuzimin e ankesës tonë, vlerësojmë që të parashtrojmë disa argumente shtesë pranë KPP si vijon:

8. Referuar përgjigjes së Autoritetit Kontraktor OB konstatohet se lidhur me ankesën e paraqitur nga ANKIMUESI “ALBGARDEN” SH.P.K, për OE “ASI INVEST” sh.p.k. dhe OE “SILVER” sh.p.k., konstatohet se OBP nuk ka paraqitur asnjë analizë, asnjë argument, asnjë provë, si dhe asnjë fakt në mbështetje dhe me qëllim argumentimin e vendimmarrjes së AK. KSHA thjesht sa i ka hedhur një sy të përgjithshëm dokumentacionit të këtyre OE, e rrjedhimisht përgjigja e saj është me karakter të përgjithshëm, ose e thënë shkurt: I hodhëm dhe një sy dokumentacionit të OE ASi Invest dhe Silver dhe sipas nesh janë në rregull. E nderuar KPP, ky veprim është një papërgjegjshmëri e madhe në kufijtë e shpërdorimit të detyrës. Sjellim në vëmendjen tuaj se Ligjvënësi në nenin 114, “Trajtimi i ankesës nga autoriteti ose enti kontraktor” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, në pikat 3 dhe 4 ka përcaktuar se:

“3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë:

- a) pranimin e plotë të ankesës,
- b) pranimin e pjesshëm të ankesës,
- c) refuzimin e ankesës.

4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankimuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme

të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

9. Duke analizuar përgjigjen e AK (OBP) në lidhje me trajtimin e ankesës tonë për OE “ASI INVEST” sh.p.k. dhe OE “SILVER” sh.p.k., qartazi rezulton se nuk është respektuar procedura ligjore e përcaktuar në nenin 114, pika 4 të Ligjit 162/2020, pasi KSHA nuk ka paraqitur asnjë shpjegim apo dokumentacion që të përlligjë vendimmarjen e saj për refuzimin e ankesës tonë. Nga ana tjetër, ankesa e paraqitur nga OE “AlbGarden” sh.p.k., është e plotë me një analizë të gjërë ligjore e financiare dhe e shoqëruar me fakte e argumente të shumta në mbështetje të pretendimeve të ngritura. Nisur nga përgjigja dhe refuzimi i AK për pretendimet tona vlerësojmë dhe arrijmë në përfundimin logjik se thjesht AK nuk ka asnjë fakt apo argument në mbështetje të përgjigjes së tij dhe pikërisht për këtë arsye e ka trajtuar ankesën në tërësi, pa dhënë argumenta dhe pa hyrë në detaje. **Në këto kushte kërkojmë që KPP të shqyrtojë në themel ankesën tonë dhe pasi ta analizojë ta pranojë atë duke skualifikuar OE “ASI INVEST” sh.p.k. dhe OE “SILVER” sh.p.k., nga kjo procedurë prokurimi, pasi nuk plotësojnë kriterin e ngjashëm të kryerjes së shërbimeve të mëparshme të ngjashme.**

10. Në lidhje me shqyrtimin e pretendimeve tona përsa i përket dokumentacionit të paraqitur nga OE “ED KONSTRUKSION” sh.p.k., në ndryshim nga shqyrtimi i pretendimeve tona për dy shoqëritë e cituara në pikën 9 mësipër, rezulton se AK OBP e ka respektuar kriterin formal të trajtimit dhe analizës së përcaktuar në nenin 114 pika 4 të Ligjit 162/2020. Por pavarësisht respektimit të kriterit formal, nga verifikimi i përgjigjes së Autoritetit kontraktor konstatojmë se KSHA ka gabuar në gjykimin material të ankesës tonë, duke mos kryer analizën e shërbimeve të ngjashme të kryera nga OE “ED KONSTRUKSION” sh.p.k., (i kualifikuar dhe renditur në vend të parë AK) dhe konkretisht argumentojmë:

a) KSHA në analizën e kontratës së parë të ngjashme, kontratë bazë me nr. 6759/8 prot., datë 18.06.2020 dhe shtesës së saj me nr. 37836/4 prot., nuk ka marrë në konsideratë disa elementë thelbësorë për vlerësimin dhe analizën e kontratave të ngjashme siç janë:

- i. Kontrata bazë dhe shtesa e saj “Rikonceptiini i Kopshtit Zoologjik” janë jashtë apo brenda afatit 3-vjeçar të kërkuar në kriterin e veçantë të dst 2.3.1 për kryerjen e shërbimeve të mëparshme të ngjashme brenda 3 viteve të fundit. Nga vlerësimi paraprak rezulton se këto shërbime janë jashtë afatit të kërkuar prej 3-vitesh;
- ii. Referuar përgjigjes së AK, por edhe informacionit që ne disponojmë rezulton se shoqëria “Ed Konstruktion” sh.p.k., ka marrë pjesë në këtë kontratë si anëtar i Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, e në raport me % e pjesëmarrjes së saj në BOE, si dhe nga analiza e zërave të preventivit që kjo shoqëri ka marrë përsipër të realizojë (Punime gjelbërimi dhe realizimin e zërave 10,11 dhe 12), rezulton se ajo nuk e përmbush kriterin e % së shërbimeve të ngjashme në masën 40% e fondit limit ose në vlerën 14,273,841.92 lekë pa tvsh. Ky fakt nuk është analizuar dhe përmendur aspak në përgjigjen e AK, duke cënuar në thelb integritetin e shqyrtimit të ankesës tonë.

Sqarojmë KPP se këto dy elementë janë thelbësore për vlerësimin e shërbimeve të ngjashme dhe nga shqyrtimi i përgjigjes së AK rezulton se nuk janë prekur fare.

Përsa më sipër, kërkojmë shqyrtimin nga ana e KPP të këtyre elementëve dhe rivlerësimin e kriterit për shërbime ngjashme të paraqitura nga OE “Ed Konstruksion” sh.p.k., duke urdhëruar AK të skualifikojë këtë shoqëri.

b) KSHA në analizën e kontratave të dyta të ngjashme: Kontrata shërbimi me objekt: “Shërbimi i Pastrimit në Bashkinë Dimal, lidhur midis palëve Bashkia Dimal dhe BOE “Ed Konstruksion” sh.p.k. & “Korsel” sh.p.k.; përkatësisht në datat 20.10.2021, 21.10.2022 dhe 23.10.2023 nuk ka marrë në konsideratë disa elementë thelbësorë për vlerësimin dhe analizën e kontratave të ngjashme siç janë:

- i. Natyrën e ngjashme të punimeve dhe shërbimeve të realizuara në kontratat e ngjashme në raport me shërbimet që prokurohen aktualisht. Sqarojmë KPP se kontratat e pastrimit të qytetit nuk janë asfare të ngjashme në natyrë, në procese teknologjike, në mjete, në fuqi punëtore, në ekspertizë dhe në kualifikime përkatëse me kontratat e gjelbërimit.*
- ii. Krahësimin e elementëve konkretë dhe zërave përave përkatës të kontratave të paraqitura si shërbime të ngjashme me elementët, proceset dhe zërat përkatës të objektit të prokurimit që kërkohet të prokurohet nga AK OBP.*

Sqarojmë KPP se këto dy elementë janë thelbësore për vlerësimin e shërbimeve të ngjashme dhe nga shqyrtimi i përgjigjes së AK rezulton se nuk janë marrë në analizë, si dhe nuk është prekur fare kjo metodologji shqyrtimi e imponuar nga parashikimet ligjore të nenit 114, pika 4 të Ligjit 162/2020.

Përsa më sipër, kërkojmë shqyrtimin nga ana e KPP të këtyre elementëve dhe rivlerësimin e kriterit për shërbime ngjashme të paraqitura nga OE “Ed Konstruksion” sh.p.k., duke urdhëruar AK të skualifikojë këtë shoqëri.

Sa më sipër, si dhe referuar përgjigjes së KSHA të AK, qartazi rezulton se kemi të bëjmë me “justifikime” dhe “neglizhenca” të paligjshme nga ana e AK me qëllim refuzimin e ankesës tonë.

Në këto kushte po paraqesim këto argumente shtesë pranë KPP me qëllim marrjen në konsideratë të ankesës tonë dhe shfuqizimin e vendimeve të Autoritetit Kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara për kualifikimin e OE: 1) “ED KONSTRUKSION” sh.p.k; 2) “ASI INVEST” sh.p.k., 3) “S I L V E R” sh.p.k., pasi ofertat e tyre nuk përmbushnin kriterin e kualifikimit për shërbime të ngjashme, marrjen e vendimit për skualifikimin e tyre nga procedura e prokurimit me objekt: “Shërbim i mirëmbajtjes të sipërfaqeve të gjelbra për QSUNT, për 24 muaj”; REF-43285-04-02-2025, dhe shpalljen fituese të OE “AlbGarden” shp.k., për këtë procedurë.”.

II.11. Me shkresën nr. 1463/6 prot., datë 07.08.2025 me objekt “Kërkesë për informacion” Komisioni i Prokurimit Publik me qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur ka kërkuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë informacionin si më poshtë:

“Në kuadër të shqyrtimit të një ankese, të paraqitur pranë institucionit tonë, për një procedurë prokurimi, referuar legjislacionit në fuqi, Komisionit të Prokurimit Publik i shfaqet nevoja e një informacioni nga institucioni juaj. Konkretisht:

- *Na vini në dispozicion një kopje të situacioneve për secilën nga faturat tatimore të shitjes të lëshuara nga operatori ekonomik “ASI INVEST” SHPK me NIPT: M01927023H bashkëlidhur kësaj shkresë?*

Me qëllim kryerjen e veprimeve procedurale dhe shqyrtimin në themel të pretendimeve të subjektit ankimues, mbështetur dhe në nenet 24, 115 pika 5 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe në pikën 2 të nenit 30 të vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766 datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, kërkojmë nga ana juaj të na vini në dispozicion, në një kohë sa më të shpejtë të jetë e mundur, dokumentacionin e mësipërcituar, i cili është i rëndësishëm për mbarëvajtjen e punës së Komisionit të Prokurimit Publik.”.

II.12. Me shkresën nr. 1620/1 prot, datë 29.08.2025, protokolluar me tonën me nr. 1463/9 prot, datë 01.09.2024, është depozituar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër në Komisionin e Prokurimit Publik, informacionin si më poshtë:

“Në përgjigje të shkresës tuaj Nr. 1463/6 Prot. datë 07.08.2025 drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë dhe protokolluar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë me Nr. 16064 datë 11.08.2025, dërguar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë me shkresën Nr. 16064/1 datë 22.08.2025 Drejtorisë Rajonale Tatimore Dibër (DRT Dibër) dhe e protokolluar në DRT Dibër me Nr. 1620 Prot. datë 25.08.2025 ku kërkon informacion për tatimpaguesin “ASI INVEST” me Nipt M01927023H lidhur me fatura e shitjes të lëshuara nga ky tatimpagues bashkëngjitur shkresës tuaj ju sqarojmë si më poshtë.

Nga verifikimi në sistemin C@TS dhe CPCM të gjithë faturat e lëshuara janë të fiskalizuar. Lidhur me situacionet për secilën faturë nuk ka të dorëzuara në sistemin C@TS pasi nuk është detyrim që subjekti të dorëzojë. Situacionet kontrollohen vetëm në rast se subjekti është në procedurë kontrolli ku bëhet analizë e hollësishme lidhur me mallrat e përdorura. Përsa i përket periudhës kur janë lëshuar këto fatura ky subjekt nuk është kontrolluar nga ana jonë.”.

II.13. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë paraqitur argumente nga ana e operatorëve ekonomikë të interesuar “ASI INVEST” SHPK dhe “ED KONSTRUKSION” SHPK, në përputhje me parashikimet e nenit 113 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar .

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “AlbGarden” SHPK, mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “ED KONSTRUKSION” ShPK, “ASI INVEST” ShPK dhe “SILVER” ShPK në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen se: “ ... Sa më sipër qartazi rezulton se oferta e paraqitur nga OE “ED KONSTRUKSION” sh.p.k., nuk e përmbush kriterin e kërkuar nga AK për shërbimet e ngjashme, e për pasojë duhet të skualifikohet. ... Sa më sipër qartazi rezulton se oferta e paraqitur nga OE “ASI INVEST” sh.p.k., nuk e përmbush kriterin e kërkuar nga AK e për pasojë duhet të skualifikohet. ... Sa më sipër qartazi rezulton se oferta e paraqitur nga OE “SILVER” sh.p.k., nuk e përmbush kriterin e kërkuar nga AK e për pasojë duhet të skualifikohet. ” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 9 “**FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**” pika 2.3.1 “*Kapacitetin teknik*” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues, si më poshtë:

“2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.”.

III.1.2. Në shtojcën 6 “**FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**”, në dokumentet standarde të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar specifikimet teknike të shërbimeve objekt prokurimi, si dhe grafikun e afatin e realizimit të këtyre shërbimeve, si më poshtë vijon:

Shtojca 6.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Objekti i kontratës: “Shërbim i mirëmbajtjes të sipërfaqeve të gjelbra për QSUNT, për 24 muaj”:

Nr.	Përshkrimi	Njesia	Sasia	Frekuenca per 24 muaj
1	<i>Pastrim me krehër bari i mjediseve të gjelbërta dhe largimi i tyre</i>	m2	23,855	730
2	<i>Punim me bel, shkretim plisash, nivelim dhe largim mbeturinash</i>	m2	5,000	24
3	<i>Furnizim dhe mbjellje farë bari (50 g /m2)</i>	m2	5,000	8
4	<i>Prashitje shkurresh dhe druresh+ plehrim kimik drurë (nitrati)</i>	copë	4,650	28
5	<i>Krasitje e gardheve të gjelbra dhe largimi i tyre</i>	ml	1,800	28
6	<i>Pleherim shpërndarje me pleh organik</i>	m2	1,000	2
7	<i>Spërkatje me insekticide</i>	copë	300	10
8	<i>Kositje bari me kosë dhe largimi i tyre</i>	m2	23,855	28
9	<i>Vaditje sipërfaqeve të gjelbërta me autobot</i>	m2	23,855	300

Pastrimi me krehër bari, është një proces që duhet të kryet çdo ditë, kjo për arsye se fluksi i vizitorëve në QSUT është i madh, por edhe për faktin që (Pastrim me krehër bari i mjediseve të gjelbërta dhe largimi i tyre), bën ajrosjen e barit dhe për rrjedhojë, rigjenerimi dhe mirëmbajtja e sipërfaqeve të gjelbra, do të sjellë në çdo kohë sipërfaqe të gjelbëruar.

(Punim me bel, shkretim plisash, nivelim dhe largim mbeturinash), **(Furnizim dhe mbjellje farë bari (50g/m²))**, **(Prashitje shkurresh dhe druresh + plehrim kimik drurë (nitrati))** janë domosdoshmëri për sipërfaqet e dëmtuara duke bërë një rikompozim të tyre, por edhe çdo pemë dhe shkurre dekorative, ka nevojë për kryerjen e këtyre zërave me qëllim marrjen e ujit dhe plehërave kimike, krijon efekte relaksuese për syrin e vizitorëve dhe punonjësve. Të gjithë këta zëra, kryhen njëri mbas tjetrit, por në funksion të njëri - tjetrit dhe moskryerja e një zëri pengon zhvillimin e punës në mënyrë lineare.

Gërmimi (punimi) i tokës rreth shkurreve/pemëve, **(Pleherim shpërndarje me pleh organik)** spërkatja e bimëve me kimikate janë procedura të rëndësishme që përfshijnë trajtimin e kopshtit për dëmtuesit dhe sëmundjet. Mbledhja me gërmime ndihmon në luftimin e dëmtuesve që jetojnë në tokë. Kjo procedurë kryhet pak para spërkatjes së kopshtit me agjentë mbrojtës.

Krasitje e gardheve të gjelbërta, **Kositje bari dhe largimi i tyre**, janë zëra që jo vetëm janë domosdoshmëri për higjenën e terrenit, por sjellin një imazh qetësues për syrin e çdo vizitori, apo punonjësi në QSUT.

Vaditje sipërfaqeve të gjelbra me autobot, është llogaritur të kryhet në periudhat më të nevojshme, sidomos në periudhën e verës, ku vaditja është e përditshme, si rezultat i temperaturave të larta, por edhe pranvera dhe vjeshta, referuar ndjekjes vit mbas viti të këtij shërbimi, e ka të domosdoshme vaditjen e sipërfaqeve të gjelbra disa herë në muaj.

Spërkatje me insekticide, është një zë tepër i nevojshëm për largimin e inskteve nga pemët. Ky zë kryhet në periudhën pa çelur gjethja dhe vijon deri në muajin gusht.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Shërbimi i mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbra duhet të ofrohet në mënyrë sa më cilësore, pasi QSUT ka në fokus cilësinë e kujdesit ndaj pacientit. Ky shërbim ka ndikim direkt jo vetëm tek përmirësimi i shëndetit të pacientit por dhe tek stafi mjekësor e jomjekësor, si dhe tek vizitorët apo qytetarët që qarkullojnë brenda territorit të QSUT. A.K. kërkon nga Subjekti që do të ofrojë këtë shërbim, si më poshtë:

- 1. Grafiku i zbatimit të shërbimit për çdo muaj, pas miratimit nga A.K. do merret nga O.E. disa ditë para fillimit të muajit pasardhës;*
 - Të mos mungojnë në magazinat e tyre, asgjë e domosdoshme për çdo ditë pune, që nga krehërat e barit, makinat korrëse, gërshërët për krasitje, koshat e nevojshëm për mbledhjen e mbeturinave (nga kositja, korrja, krehërimi etj), fidanë për zëvendësimin e rrënjëve të reja të dëmtuara, plehëra kimik, etj.*
- 2. Pastrimi i sipërfaqeve të gjelbërta do të bëhet me krëhër bari.*
- 3. Kositja, ujitja, krasitja, mbjellja etj, do të bëhen sipas preventivit dhe sezoneve përkatëse.*
- 4. Personeli përgjegjës për zbatimin e kontratës, është i detyruar të:*
 - Të zbatojë në punë orarin e caktuar.*
 - Të ketë etikë dhe komunikim gjatë procesit të punës.*
 - Të jenë bashkëpunues në rastet e nevojshme dhe të veçanta për ofrimin ekstra të këtij shërbimi.*
 - Të zbatojnë me përpikmëri zërat e preventivit, sipas planit mujor të miratuar.*
 - Punëtorët do të jenë të veshur me veshjet përkatëse identifikuese të paisur me doreza (të miratuara nga Autoriteti Kontraktor), me kartat identifikuese të personelit (të miratuara nga Autoriteti Kontraktor), si dhe do të zbatojnë rregullat e brendshme, rregulloren e monitorimit të këtij shërbimi, të vendosura nga Q.S.U.T-ja.*
- 5. O.E. duhet të ketë numrin e punëtorëve dhe përgjegjësit e tyre (sipas kontratës) dhe do t'i vihet lista emërore në dispozicion A.K. menjëherë me lidhjen e kontratës.*

Për mirëmbajtjen ditore të sipërfaqeve të gjelbërta të territorit të QSUT-së, është e rëndësishme ndarja e këtij territori në zonat e mëposhtme, në mënyrë që mbulimi i mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbra përreth këtyre godinave që përmban cdo zone, të ketë mbulimin e duhur sipas grafikut mujor që do ti jepet O.E. nga A.K. çdo muaj. OE është i detyruar ti përgjigjet kërkesave të AK për ndarjen e punës me oraret që çdo zë i këtij shërbimi ka si protokoll të kryhet. Punëtorët do të punojnë paradite, por edhe pasdite dhe në oraret e mëngjesit herët apo vonë në darkë sidomos për zërin vaditje.

Zona e parë, përfshin sipërfaqet e gjelbërta përreth këtyre godinave: Hyrja Kryesore për në QSUT, Spitali Onkologjik përreth gjithë sipërfaqes së tij, Akseleratorin Onkologjik, Godinën e Spitalit Infektiv dhe sipërfaqet përreth tij, Godina e Konsultave;

Zona e dytë, përfshin sipërfaqet e gjelbërta përreth këtyre godinave : godina e Djegie Plastikës (para dhe mbrapa saj), Klinikat Kirurgjikale (rreth klinikave nga jashtë dhe brënda), Spitalin e Ri (Urgjencat), Spitalin Nr.1 (6 katëshin) përpara dhe pjesën mbrapa, Reparti Qendror i Kaldajave, Mjekësinë Ligjore;

Zona e tretë, përfshin sipërfaqet e gjelbërta përreth këtyre godinave: Godinën e Statistikës (ish-rektorati), të dy godinat e Pediatrie.

Zona e katërt, përfshin sipërfaqet e gjelbërta përreth këtyre godinave: Drejtorinë e Përgjithshme, Depon Qëndrore të ujit, Spitalin Francez, Godinën e Kardiokirurgjisë dhe Kirurgjisë Vaskulare, rrugën mbrapa spitalit francez (rruga shameti) deri tek hyrja/dalja e pediatrie;

Zona e pestë, përfshin sipërfaqet e gjelbërta përreth godinave të Spitalit Nr.5 (Neurologjinë, Neurokirurgjinë, Shërbimin e Psikiatrie);

Zona e gjashtë përfshin sipërfaqet e gjelbra përreth Spitalit Qendror (Godina A2) , e cila është funksionale si godinë nga muaji mars 2023.

O.E. është i detyruar të zbatojë me përgjegjshmëri, të gjitha pikat e preventivit sipas planit mujor të punës të miratuar, por edhe të jetë i vëmendshëm në mirëmbajtjen e këtyre sipërfaqeve.

O.E. duhet:

- Të pastrojë me krehër sipërfaqet e gjelbra, për ta mbajtur të gjelbër dhe të shëndetshëm, këtë sipërfaqe.
- Të mirëmbajë sipërfaqet e dëmtuara, nga ulja pa kriter e njerëzve dhe nga thatësitat e periudhës së verës.
- Të ujisë me autobot, sipas sezoneve gjithë sipërfaqen e gjelbër.
- Të mos përdorë ujin e pijshëm të QSUT-së, për ujitje.
- Të ndihmojë profesionalisht për shtimin e sipërfaqeve të gjelbërta dhe ambienteve relaksuese, rreth godinave spitalore.
- Të jenë bashkëpunues, për çdo të papritur dhe tu përgjigjen kërkesave të Q.S.U.T-së.
- Të krasit gardhet e gjelbërta dhe drurët në forma bashkëkohore nga specialistë të mirëfilltë.
- Të vendosen tabela ndërgjegjëse, në vendet e duhura për të ruajtur gjelbërimin.

Aktiviteti Ditor (A.D.)

- **A.D. gjatë sezonit të verës:**

1. Vadtja do të bëhet sipas grafikëve mujorë, për ruajtjen e sipërfaqeve të gjelbërta, duke i'u referuar protokolleve (mëngjes herët pa lindjen e diellit dhe në darkë vonë pas perëndimit të diellit).

- **A.D. gjatë sezonit të pranverës:**

1. Sipërfaqet e QSUT-së të modelohen me shkurre dekorative, gardhe ligustre dhe të mirëmbahen sipas protokolleve.

- **A.D. gjatë sezonit vjeshtë-dimër:**

1. Bari të pastrohet me krehër më shpesh, duke qenë se ndodh rënia e gjetheve nga pemët.
2. Të marren masa nga O.E. për heqjen e pemëve të infektuara, të dëmtuara dhe që paraqesin rrezik për jetën e njeriut.

- **A.D. gjatë sezonit të mbjelljes:**

1. Çdo sezon mbjelljeje, O.E është i detyruar të shtojë sipërfaqet e gjelbra me bar dhe lule, duke i'u përgjigjur kërkesave të QSUT-së.
2. Të mirëmbajë sipërfaqet e dëmtuara të barit me punime toke, plehërim dhe mbjellje.
3. Të jetë bashkëpunues dhe të kryej punime cilësore.

Kontrollet e çdo ditë do të synojnë sa më sipër, por edhe në zërat kryesorë të preventivit:

- Mirëmbajtje lulishtesh me bar natyral.
- Mirëmbajtje, ripërtëritje shkurre dekorative.
- Pastrim me krëhër i mjedisve të gjelbërta.
- Prashitje shkurre.
- Krasitje e gardheve të gjelbra.
- Kositje bari me kosë/makinë korrëse dhe largimi i mbeturinave të tyre.
- Vadtje sipërfaqe të gjelbërta (bar natyral dhe bar i kultivuar) (përveç ditëve me shi).
- Vadtje pemësh, fidanësh.
- Të bëhet prashitja e shkurreve/luleve dhe pemëve, sa herë të jetë e nevojshme.
- Rikompozimi i sipërfaqeve sipas nevojës dhe kërkesës së AK.

Vendosja e tabelave ndërgjegjësuere për mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbërta dhe mbajtjen pastër, të çdo pjese jashtë godinave spitalore.

III.1.3. Në shtojcën 7, “**FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT**”, në dokumentet standarde të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar llojin e shërbimeve objekt prokurimi, si dhe grafikun e afatit të realizimit të këtyre shërbimeve, si më poshtë vijon:

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: “Shërbim i mirëmbajtjes të sipërfaqeve të gjelbra për QSUNT, për 24 muaj”.

Nr.	Përshkrimi	Njesia	Sasia	Frekuenca per 24 muaj
1	Pastrim me krehër bari i mjediseve të gjelbërta dhe largimi i tyre	m2	23,855	730
2	Punim me bel, shkretim plisash, nivelim dhe largim mbeturinash	m2	5,000	24
3	Furnizim dhe mbjellje farë bari (50 g /m2)	m2	5,000	8
4	Prashitje shkurresh dhe druresh+ plehrim kimik drurë (nitrati)	copë	4,650	28
5	Krasitje e gardheve të gjelbra dhe largimi i tyre	ml	1,800	28
6	Pleherim shperndarje me pleh organik	m2	1,000	2
7	Spërkatje me insekticide	copë	300	10
8	Kositje bari me kosë dhe largimi i tyre	m2	23,855	28
9	Vaditje sipërfaqeve të gjelbërta me autobot	m2	23,855	300

Grafiku i zërave për vitin e parë të kontratës

Nr.	Përshkrimi	<i>jana</i> <i>r</i>	<i>shkurt</i>	<i>mar</i> <i>s</i>	<i>prill</i>	<i>maj</i>	<i>qesho</i> <i>r</i>	<i>korri</i> <i>k</i>	<i>gush</i> <i>t</i>	<i>shtator</i>	<i>tetor</i>	<i>nënt</i> <i>or</i>	<i>dhjet</i> <i>or</i>	Tot ali
1	Pastrim me krehër bari i mjediseve të gjelbërta dhe largimi i tyre	31	28	31	30	31	30	31	31	30	31	30	31	365
2	Punim me bel, shkretim plisash, nivelim dhe largim mbeturinash	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	12
3	Furnizim dhe mbjellje farë bari (50 g /m2)			1		1	1			1				4
4	Prashitje shkurresh dhe druresh+ plehrim kimik drurë (nitrati)			2	2	2	2	2	2	2				14
5	Krasitje e gardheve të gjelbra dhe largimi i tyre			2	2	2	2	2	2	1	1			14
6	Pleherim shperndarje me pleh organik			1										1
7	Spërkatje me insekticide				1	1	1	1	1					5
8	Kositje bari me kosë dhe largimi i tyre			2	2	2	2	2	2	1	1			14
9	Vaditje sipërfaqeve të gjelbërta me autobot			4	5	15	30	31	31	15	15	4		150

Grafiku i zërave për vitin e dytë të kontratës

Nr.	Përshkrimi	jana r	shkurt	mar s	prill	maj	qeshor	korri k	gush t	shtato r	tetor	nënt or	dhjet or	Tot ali
1	Pastrim me krehër bari i mjediseve të gjelbërta dhe largimi i tyre	31	28	31	30	31	30	31	31	30	31	30	31	365
2	Punim me bel, shkristim plisash, nivelim dhe largim mbeturinash	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	12
3	Furnizim dhe mbjellje farë bari (50 g /m2)			1		1	1			1				4
4	Prashitje shkurresh dhe druresh+ plehrim kimik drurë (nitrati)			2	2	2	2	2	2	2				14
5	Krasitje e gardheve të gjelbra dhe largimi i tyre			2	2	2	2	2	2	1	1			14
6	Pleherim shperndarje me pleh organik			1										1
7	Spërkatje me insekticide				1	1	1	1	1					5
8	Kositje bari me kosë dhe largimi i tyre			2	2	2	2	2	2	1	1			14
9	Vaditje sipërfaqeve të gjelbërta me autobot			4	5	15	30	31	31	15	15	4		150

Afatet e ekzekutimit:

Afati i ekzekutimit të shërbimit është: 24 muaj.

III.1.4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik përkatësisht nga operatori ekonomik “SILVER” SHPK për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton, se ky i fundit kaparaqitur dokumentacionin, si më poshtë vijon:

1. Faturë tatimore shitje (elektronike) nr. XXXX, datë XX.XX.2025, emëtuar nga shitësi “SILVER” SHPK për blerësin Drejtoria e Përgjithshme e Arkivit Tiranë, me objekt: “Shërbim pastrim gjelbërim”, me vlerë 327.130 leke pa TVSH.
2. Faturë tatimore shitje (elektronike) nr. XXXX, datë XX.XX.2025, emëtuar nga shitësi “SILVER” SHPK për blerësin “XXXX” SHPK, me objekt: “Shërbim gjelbërim”, me vlerë 1.954.800 leke pa TVSH.
3. Faturë tatimore shitje (elektronike) nr. XXXX, datë XX.XX.2025, emëtuar nga shitësi “SILVER” SHPK për blerësin “XXXX” SHPK, me objekt: “Shërbim gjelbërim”, me vlerë 600.000 leke pa TVSH.
4. Faturë tatimore shitje (elektronike) nr. XXXX, datë XX.XX.2025, emëtuar nga shitësi “SILVER” SHPK për blerësin “XXXX” SHPK, me objekt: “Gjelbërim Vilat në Farkë”, me vlerë 1.954.000 leke pa TVSH.
5. Faturë tatimore shitje (elektronike) nr. XXXX, datë XX.XX.2025, emëtuar nga shitësi “SILVER” SHPK për blerësin “XXXX” SHPK, me objekt: “Shërbim gjelbërimi”, me vlerë 880.000 leke pa TVSH.

6. Faturë tatimore shitje (elektronike) nr. XXXX, datë XX.XX.2025, emëtuar nga shitësi "SILVER" SHPK për blerësin "XXXX" SHPK, me objekt: "Patrim territori dhe larje me autobot" me vlerë 480.000 leke pa tvsh dhe me objekt: **Shërbim gjelbërimi**", me vlerë **530.000** leke pa TVSH.
7. Faturë tatimore shitje (elektronike) nr. XXXX, datë XX.XX.2025, emëtuar nga shitësi "SILVER" SHPK për blerësin Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave Tiranë, me objekt: "Shërbim pastrim gjelbërim", me vlerë 327.130 leke pa TVSH.
8. Faturë tatimore shitje (elektronike) nr. XXXX, datë XX.XX.2025, emëtuar nga shitësi "SILVER" SHPK për blerësin "XXXX" SHPK, me objekt: **"Shërbim gjelbërimi"**, me vlerë **964.500** leke pa TVSH.
9. Faturë tatimore shitje (elektronike) nr. XXXX, datë XX.XX.2025, emëtuar nga shitësi "SILVER" SHPK për blerësin "XXXX" SHPK, me objekt: **"Gjelbërim Vilat në Farkë"**, me vlerë **2.105.400** leke pa TVSH.
10. Faturë tatimore shitje (elektronike) nr. XXXX, datë XX.XX.2025, emëtuar nga shitësi "SILVER" SHPK për blerësin "XXXX" SHPK, me objekt: **"Shërbim gjelbërimi"**, me vlerë **998.500** leke pa TVSH.
11. Faturë tatimore shitje (elektronike) nr. XXXX, datë XX.XX.2025, emëtuar nga shitësi "SILVER" SHPK për blerësin Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave Tiranë, me objekt: "Shërbim pastrim gjelbërim", me vlerë 327.130 leke pa TVSH.
12. Faturë tatimore shitje (elektronike) nr. XXXX, datë XX.XX.2025, emëtuar nga shitësi "SILVER" SHPK për blerësin "XXXX" SHPK, me objekt: **"Shërbim gjelbërimi"**, me vlerë **2.570.900** leke pa TVSH.
13. Faturë tatimore shitje (elektronike) nr. XXXX, datë XX.XX.2024, emëtuar nga shitësi "SILVER" SHPK për blerësin Drejtoria e Prgjithshme e Arkivave Tiranë, me objekt: "Shërbim pastrim gjelbërim", me vlerë 327.130 leke pa TVSH.
14. Faturë tatimore shitje (elektronike) nr. XXXX, datë XX.XX.2024, emëtuar nga shitësi "SILVER" SHPK për blerësin Drejtoria e Prgjithshme e Arkivave Tiranë, me objekt: "Shërbim pastrim gjelbërim", me vlerë 327.130 leke pa TVSH.
15. Faturë tatimore shitje (elektronike) nr. XXXX, datë XX.XX.2024, emëtuar nga shitësi "SILVER" SHPK për blerësin "XXXX" SHPK, me objekt: **"Shërbim gjelbërim"**, me vlerë **744.800** leke pa TVSH.

16. Faturë tatimore shitje (elektronike) nr. XXXX, datë XX.XX.2024, emëtuar nga shitësi "SILVER" SHPK për blerësin Drejtoria e Prgjithshme e Arkivave Tiranë, me objekt: "Shërbim pastrim gjelbërim", me vlerë 327.130 leke pa TVSH.
17. Faturë tatimore shitje (elektronike) nr. XXXX, datë XX.XX.2024, emëtuar nga shitësi "SILVER" SHPK për blerësin Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave Tiranë, me objekt: "Shërbim pastrim gjelbërim", me vlerë 327.130 leke pa TVSH.
18. Faturë tatimore shitje (elektronike) nr. XXXX, datë XX.XX.2024, emëtuar nga shitësi "SILVER" SHPK për blerësin "XXXX" SHPK, me objekt: "**Shërbim gjelbërim**", me vlerë **500.000** leke pa TVSH.
19. Faturë tatimore shitje (elektronike) nr. XXXX, datë XX.XX.2024, emëtuar nga shitësi "SILVER" SHPK për blerësin Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave Tiranë, me objekt: "Shërbim pastrim gjelbërim", me vlerë 327.130 leke pa TVSH.
20. Faturë tatimore shitje (elektronike) nr. XXXX, datë XX.XX.2024, emëtuar nga shitësi "SILVER" SHPK për blerësin "XXXX" SHPK, me objekt: "**Shërbim gjelbërim**", me vlerë **483.700** leke pa TVSH.
21. Faturë tatimore shitje (elektronike) nr. XXXX, datë XX.XX.2024, emëtuar nga shitësi "SILVER" SHPK për blerësin "XXXX" SHPK, me objekt: "**Shërbim gjelbërim**", me vlerë **511.000** leke pa TVSH.
22. Faturë tatimore shitje (elektronike) nr. XXXX, datë XX.XX.2024, emëtuar nga shitësi "SILVER" SHPK për blerësin Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave Tiranë, me objekt: "Shërbim pastrim gjelbërim", me vlerë 327.130 leke pa TVSH.
23. Faturë tatimore shitje (elektronike) nr. XXXX, datë XX.XX.2024, emëtuar nga shitësi "SILVER" SHPK për blerësin Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave Tiranë, me objekt: "Shërbim pastrim gjelbërim", me vlerë 327.130 leke pa TVSH.
24. Faturë tatimore shitje (elektronike) nr. XXXX, datë XX.XX.2024, emëtuar nga shitësi "SILVER" SHPK për blerësin Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave Tiranë, me objekt: "Shërbim pastrim gjelbërim", me vlerë 327.130 leke pa TVSH.
25. Faturë tatimore shitje (elektronike) nr. XXXX, datë XX.XX.2024, emëtuar nga shitësi "SILVER" SHPK për blerësin Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave Tiranë, me objekt: "Shërbim pastrim gjelbërim", me vlerë 327.130 leke pa TVSH.

III.1.5. Në nenin 2 "Qëllimi" të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

"Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.1.6. Në nenin 77, pika 1 dhe pika 4, “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.1.7. Ndërsa në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar përcaktohet se:

“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e 26 përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.”.

III.1.8. Në nenin 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” pika 3, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre vjetëve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre vjetëve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e prokurimit të shërbimeve me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit, do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.”.

III.1.9. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi i kualifikimit i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

III.1.10. Fillimisht KPP, gjykon të ndalet në një analizë të thelluar të kërkesës kualifikuese të përcaktuar në pikën 2.3.1 “*Kapaciteti teknik*” të përcaktuara në shtojcën 9 “*FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Në shtojcën 6 “*FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE*” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar specifikimet teknike të shërbimit objekt prokurimi, ndërkohë që në shtojcën 7 “*FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT*” të po këtyre dokumentave autoriteti kontraktor ka përcaktuar llojin, sasinë dhe afatin e ekzekutimit të shërbimit objekt prokurimi, ku konstatohet se objekti i prokurimit është “*Shërbim i mirëmbajtjes të sipërfaqeve të gjelbra për QSUNT, për 24 muaj*”, cila përfshin shërbimet si në vijim: “*Pastrim me krehër bari i mjediseve të gjelbërta dhe largimi i tyre; Punim me bel, shkriftim plisash, nivelim dhe largim mbeturinash; Furnizim dhe mbjellje farë bari (50 g /m²); Prashitje shkurresh dhe drurësh+ plehrim kimik drurë (nitrati); Krasitje e gardheve të gjelbra dhe largimi i tyre; Plehërim shpërndarje me pleh organik; Spërkatje me insekticide; Kositje bari me kosë dhe largimi i tyre dhe Vaditje sipërfaqeve të gjelbërta me autobot.*”.

Në kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.1 “*Kapaciteti teknik*” të përcaktuara në shtojcën 9 “*FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, pra shërbime të ngjashme të realizuara nga data 03.04.2025 (data e shpalles së procedurës) dhe deri më datë 03.05.2022 (data e fundit e afatit 3 vjeçar nga data e publikimit), ku vlera e këtyre shërbimeve duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të procedurës së prokurimit, pra në vlerën jo më pak se 14.273.841,92 (katërmëdhjet milion e dyqind e shtatëdhjet e tre mijë e tetëqind e dyzet e një presje nëntëdhjet e dy) leke pa-TVSH, ku në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, ndërsa në rastin përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

III.1.11. Referuar sa më sipër, nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “*AlbGarden*” SHPK, mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “*SILVER*” ShPK, dokumentacioni i ofertës i dorëzuar nga shoqëria “*SILVER*” ShPK, si dhe kriteri kualifikues i përcaktuar në pikën 2.3.1 “*Kapaciteti teknik*” të përcaktuara në shtojcën 9 “*FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, Komisioni vëren se shoqëria “*SILVER*” ShPK për plotësimin e kriterit kualifikues lidhur me eksperiencën e mëparshme për realizimin e me sukses të shërbimeve të ngjashme të përcaktuar në pikën

2.3.1 “Kapaciteti teknik” të përcaktuara në shtojcën 9 “*FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit, ky operator ekonomik ka dorëzuar gjithsej 25 (njëzet e pesë) fatura tatimore shitje. Nga shqyrtimi i këtyre faturave, Komisioni konstaton se në 12 (dymbëdhjetë) fatura dhe konkretisht faturat tatimore të shitjes si në vijim: “*Faturë tatimore shitje (elektronike) nr. 88839, datë 31.01.2025; Faturë tatimore shitje (elektronike) nr. 88858, datë 28.02.2025; Faturë tatimore shitje (elektronike) nr. 88877, datë 31.03.2025; Faturë tatimore shitje (elektronike) nr. 88808, datë 23.12.2024; Faturë tatimore shitje (elektronike) nr. 88671, datë 31.07.2024; Faturë tatimore shitje (elektronike) nr. 88786, datë 27.11.2024; Faturë tatimore shitje (elektronike) nr. 88426, datë 31.01.2024; Faturë tatimore shitje (elektronike) nr. 88458, datë 29.02.2024; Faturë tatimore shitje (elektronike) nr. 88506, datë 29.03.2024; Faturë tatimore shitje (elektronike) nr. 88559, datë 30.04.2024; Faturë tatimore shitje (elektronike) nr. 88559, datë 31.05.2024 dhe Faturë tatimore shitje (elektronike) nr. 88635, datë 28.06.2024*”, kanë në cilësinë e blerësit ente publike, të cilat e përmbushin kriterin kualifikues përsa i përket dokumentacionit vërtetues të realizimit të shërbimeve të ngjashme të realizuara më ente publike, pasi në kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.1 “*Kapaciteti teknik*” të përcaktuara në shtojcën 9 “*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit është përcaktuar që operatorët ekonomik mund të paraqesin vetëm faturën tatimore të shitjes, ndërsa 13 (trembëdhjetë) fatura tatimore shitje dhe konkretisht faturat tatimore të shitjes si në vijim: “*Faturë tatimore shitje (elektronike) nr. 88889, datë 02.04.2025; Faturë tatimore shitje (elektronike) nr. 88886, datë 02.04.2025; Faturë tatimore shitje (elektronike) nr. 88884, datë 02.04.2025; Faturë tatimore shitje (elektronike) nr. 88885, datë 02.04.2025; Faturë tatimore shitje (elektronike) nr. 88855, datë 28.02.2025, Faturë tatimore shitje (elektronike) nr. 88873, datë 27.03.2025; Faturë tatimore shitje (elektronike) nr. 88870, datë 25.03.2025; Faturë tatimore shitje (elektronike) nr. 88872, datë 26.03.2025; Faturë tatimore shitje (elektronike) nr. 88879, datë 31.03.2025; Faturë tatimore shitje (elektronike) nr. 88735, datë 07.10.2024; Faturë tatimore shitje (elektronike) nr. 88422, datë 31.01.2024; Faturë tatimore shitje (elektronike) nr. 88460, datë 29.02.2024 dhe Faturë tatimore shitje (elektronike) nr. 88505, datë 29.03.2024*”, kanë në cilësinë e blerësit ente private, të cilat e përmbushin kriterin kualifikues përsa i përket dokumentacionit vërtetues të realizimit të shërbimeve të ngjashme të realizuara me subjekte private, pasi në kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.1 “*Kapaciteti teknik*” të përcaktuara në shtojcën 9 “*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit është përcaktuar që operatorët ekonomik mund të paraqesin vetëm faturën tatimore të shitjes, ndaj dhe do të merren në shqyrtim nga Komisioni lidhur me plotësimin e këtij kriteri kualifikues.

Nga shqyrtimi i këtyre faturave, Komisioni konstaton se shërbimet e realizuara nëpërmjet këtyre faturave janë realizuar brenda afat 3 (tre) vjeçar nga data e publikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, ndërsa lidhur me natyrën e ngjashmë të shërbimeve Komisioni konstaton se operatori ekonomik ofertues “SILVER” SHPK ka realizuar shërbime të mëparshme me subjekte private si në vijim: “*Shërbim gjelbërim dhe Gjelbërim Vilat në Farkë*”, të cilat për nga natyra janë të ngjashme me objektin e prokurimit “*Shërbim i mirëmbajtjes të sipërfaqeve të gjelbra për QSUNT, për 24 muaj*”, i cili përfshin shërbimet si në vijim: “*Pastrim me krehër bari i mjediseve të gjelbërta dhe largimi i tyre; Punim me bel, shkriftim plisash, nivelim dhe largim mbeturinash; Furnizim dhe mbjellje farë bari (50 g*

/m2); Prashitje shkurresh dhe drurësh+ plehrim kimik drurë (nitrat); Krasitje e gardheve të gjelbra dhe largimi i tyre; Plehërim shpërndarje me pleh organik; Spërkatje me insekticide; Kositje bari me kosë dhe largimi i tyre dhe Vaditje sipërfaqeve të gjelbërta me autobot.”, ku vlera e këtyrë shërbimeve të realizuara është në vlerën **14.797.600** (katërmëdhjet milion e shtatëqind e nëntëdhjet e shtatë mijë e gjashtëqind) leke pa TVSH, duke e plotësuar vlerën e shërbimeve të ngjashme të kërkuara në kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.1 “Kapaciteti teknik” të përcaktuara në shtojcën 9 “*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni gjykon se pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “*AlbGarden*” SHPK, mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “*SILVER*” SHPK lidhur me shërbimet e ngjashme nuk qëndron, pasi operatori ekonomik ofertues “*SILVER*” SHPK me dokumentacionin e dorëzuar vërteton se ka realizuar shërbime gjelbërimi të realizuara me subjekte private, të cilat janë të ngjashme me objektin e prokurimit dhe për më tepër këto shërbime janë realizuar brenda afatit 3 (tre) vjeçar nga data e shpalljes së procedurës së prokurimit, si dhe janë në vlerën **14.797.600** (katërmëdhjet milion e shtatëqind e nëntëdhjet e shtatë mijë e gjashtëqind) leke pa TVSH, duke plotësuar kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.1 “Kapaciteti teknik” të përcaktuara në shtojcën 9 “*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Përsa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik “*AlbGarden*” SHPK për skualifikimin e ofertës së shoqërisë “*SILVER*” SHPK nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “*AlbGarden*” SHPK për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “*ED KONSTRUKSION*” SHPK dhe “*ASI INVEST*” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se:

III.2.1. Parashikimi i nenit 94 pika 1 e VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, kërkohej shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor.

Sa më sipër KPP gjykon, se është e nevojshme të ndalet në elementet e testit të legjitimitetit në një procedurë ankimi përpara KPP. Këto elemente janë interesi i ankuesit, dëmi real ose potencial i pritshëm dhe ekzistenca e një vendimi të një autoriteti kontraktor i marrë në kundërshtim me ligjin.

III.2.2. Një ankimues do të konsiderohet i dëmtuar apo disavantazhuar, kur ai ka vuajtur apo rrezikon dukshëm të vuajë personalisht një pasojë të ardhur drejtpërdrejtë nga veprimi i autoritetit kontraktor dhe kjo mund të kurohet (rregullohet) përmes ankimit në KPP. Gjithashtu, akti i pretenduar duhet të ketë ndodhur në hapësirën e të drejtave të tij ligjore në kuadrin e një procedure prokurimi publik.

III.2.3. I vetmi interes i ligjshëm, që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhënë në kuadrin e një procedure prokurimi, është që përmes ankimit në KPP, ai të fitojë kontratën.

Për sa kohë që pas shqyrtimit të pretendimit mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “SILVER” SHPK, të palës ankimuese, Komisioni i Prokurimit Publik gjykoi, se ky pretendim nuk qëndron dhe në këtë mënyrë ka lënë në fuqi vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të datës 22.05.2025 dhe gjendja faktike juridike e operatorit ekonomik “SILVER” SHPK, mbetet e kualifikuar, pretendimet e tjera të palës ankimuese për skualifikimin e ofertave të operatorëve të tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, në rastin konkret për operatorin ekonomik “ED KONSTRUKSION” SHPK dhe operatorin ekonomik “ASI INVEST” SHPK nuk merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ, pasi cilido qoftë fati i pretendimeve të tij, pala ankimuese nuk mund të arrijë dot qëllimin e saj final të fitimit të kontratës.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “AlbGarden” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-43285-04-02-2025, me objekt: “Shërbim i mirëmbajtjes të sipërfaqeve të gjelbra për QSUNT, për 24 muaj”, me fond limit 35,684,604.80 (tridhjetë e pesë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e katër pikë tetëdhjetë) lekë, pa TVSH ose 359,687.57 (treqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e shtatë pikë pesëdhjetë e shtatë) euro pa tvsh, zhvilluar më datë 05.05.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara Sh.A.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “AlbGarden” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

